

KOZETA KITA

LEXIMI SI RILEXIM I ROMANIT “KARPA” TË M. CAMAJT

Në këtë punim jemi përpjekur të hetojmë udhëtimin e lexuesit në tekst, i cili përfaqësohet nga personazhi, duke e vlerësuar atë si tipar karakterizues të veprës dhe kusht interpretimi. Analiza mbështetet së pari në shenjat tekstore, që flasin për një shqetësim mbi marrëdhënien autor – tekst – lexues ku ky i fundit thirret shpesh edhe si dialogues dhe së dyti në zgjidhjen e subjektit, që vjen si kompleks përfundimesh të dala nga procesi i leximit.

Romani “Karpa” është një mbivendosje tekstesh të pranishme e të papranishme, ngjarjesh, identitetesh, veprimesh e mosveprimesh tek të cilat mbërrijmë përmes personazhit – lexues si objekt dhe subjekt i ngjarjeve. Veçoria e tij rrjedh nga raporti që krijon me tekstin si produkte të njëkohshme të njëri-tjetrit dhe që gjenden në një marrëdhënie vertikale zhvillimi me prirjen drejt qendrës, të pavetëdijshmes nga formësohen e përparojnë linja ngjarjesh, ngjarje që kanë përmasën e personazhit.

Krijimi i botëve të mundshme të “Karpës” është projekt i personazhit. Në këtë formë ne lexojmë personazhin dhe përmes personazhit. Rrathët e brendashkruar të ngjarjeve rindërtojnë në mënyrë hipotetike përvojën e lexuesit real.

Kjo lloj qasje ndaj personazhit – lexues është një mënyrë e dekodifikimit të veprës nga ana formale e përmbajtjesore.

Së pari, shohim se kemi të bëjmë me një mënyrë origjinale të konceptimit të personazhit që hedh dritë mbi psikologjinë e tij. I vendosur në pozitat e lexuesit ai bëhet interpretues i situatave, aktorëve për t’u vetëzbuluar më tej përmes tyre. Manipulon ngjarjet, nxjerr jashtë të nëndheshmen, merr vendime, jep zgjidhje, dashuron, urren dhe mbi të gjitha është i lirë.

Subjekti në pjesën më të madhe ndërtohet si veprim i brendshëm, i brendashkruar, si përgjigja para pyetjes, si tekst orakull i ngarkuar me të dhëna e mesazhe.

Ideja e distancës kohore si objektivitet dhe refuzim, ngujimi në brendinë e personazhit pasqyron një vetizolim, shtypje e pasiguri. Ky projektim i vetes në kohë e hapësirë ndodh përmes leximit.

Struktura e veprës brenda së cilës përfshihen disa shtresa leximi – interpretimi është po ashtu funksion i personazhit.

Ndërsa interpretimi në aspektin teorik, është një diskutim që ka të bëjë me qëllimshmërinë e autorit, veprës dhe horizontin e pritjes.

Teksti mbi të cilin ngrihet vepra është një tekst i munguar, teknikë kjo që e bën të domosdoshme praninë e personazhit – lexues. Romani vjen tek ne përmes leximeve mbi “Kronikën” që në fakt aludohet të jetë një variant i përpunuar i kronikës historike të Karpës. Për këtë arsye trajektorja ku na çon leximi i “Karpës” është një spirale në lëvizje e cila synon zbulimin, pikënisjen, atë që ne mendojmë se është mbi të gjitha, zbulimi i vetvetes, projekcioni ynë në histori. Mbivendosja e shkrimit, leximit dhe interpretimit krijon një formë metanarrativiteti si një përsiatje që bën tekstin mbi veten.

Por sa të drejtë kemi ta konsiderojmë në analizën tonë këtë tekst të munguar? A ekziston Kronika? Për ne ekziston por vetëm si interpretim. Dyshimi i parë për ekzistencën e tij përligjet nga rrëfimtari:

“Në atë fill mori turrën e letrave të kronikës në dorë, ftohtas, si merret një libër nga lëpiza për ta lexue kur s’ke si e kalon kohën. Kronika ndahej në dy pjesë.” (f. 48)

Po në qoftë ky një kurth i tekstit, i Karpës? Atëherë i referohemi një argumenti tjetër: një vepër e dëshmon ekzistencën e saj përmes lexuesit dhe dëshmisë së tij, si strukturë dinamike¹ gjithmonë në zhvillim të pandërprerë e për pasojë të ndryshueshëm.

Ky lloj konceptimi i bashkëjetesës në tekstin e shkruar të leximit dhe interpretimit të tij i ka dhënë veprës së Camajt një tipar origjinal që lidhet me ligjërimin e disa teksteve njëkohësisht. Ligjërim ky që realizohet përmes vizionit të personazhit.

Kush e shkroi kronikën mbi Karpën? A është varianti i Gjyshit, variant i përpunuar i Kronikës së shkruar për Karpën apo është leximi i saj sipas tij? A është “Karpa” pasqyrë e ndërjegjes së trazuar të Vonit apo parashikim i fatit të personazhit në një vend ku gjithkush dhe gjithçka kontrollohet deri në hojet më të fshehta të mendimit? Të gjitha pyetjet e përgjigjet shkojnë në një pikë të përbashkët: e vërteta e tekstit është e

¹ J. Llotman, *Kultura dhe bumi*, SHLK & aleph, Tiranë, 2004, f. 32.

vërteta sipas lexuesit, ankthi i tij, e vërteta relative që përthyeret në disa vështrime.

Kështu qëllimshmëria e gjyshit për psikologun është krizë nervore.

“– Plaku ynë përnjëjtëson tash së voni, jo vetëm me vetjen e kronikës por dhe me autorin e saj.” (f. 279)

Për Vonin është provë, përvojë, madje një rrëhim në botën e tij psikologjike deri në kufijtë e të pavetëdijshmes. Kjo vihet re në raportin me Borën dhe Lejdën. Bora është gjithmonë përkrah tij. Por diku papritur në botën e të vërtetave shfaqet Lejda. E vërteta e saj si nëpër botën e hijeve.

Për historianin që e karakterizon objektiviteti është shtrembërim faktesh.

“Në përpunim e sipër të këtij dorëshkrimi, ndërrova emnat e vetjeve - rrëfeu plaku si pendueshëm tue shikue gjithnjë kah Shkriba.” (f. 275)

Ndërsa kufijtë e tekstit bëhen vështirë të identifikueshëm pasi ne e njohim vetëm si interpretim, si ndikim dhe referencë. Voni përmes vetëprojektimit ndërton një tekst hipotetik si rrjedhojë e një gjendjeje presioni psikologjik, censure që ushtrohet mbi të sapo arrin në Karpë. Një pasiguri që vjen nga e panjohura duke realizuar kështu qëllimshmërinë e veprës përmes përfshirjes së tij. Fati i Vonit personazh është fati i lexuesit, përvoja e tij. Ai nisat drejt zbulimit të një bote të panjohur, Karpës. Udhëtimi i tij kalon nga këto hallka: shkatërrim - lufta në Karpë; zbulim - zbulimi i Ilirisë; ndërtim - fshati pa emër.

Paralelisht me të dhe aventura jonë e leximit kalon përmes shkatërrimit - sipas shenjave të tekstit, zbulimit - të hijeve e “vetjeve të vërteta”, ndërtimit - rileximit të “Karpës”.

Përtej të gjithave, për ne mbetet i hapur diskutimi nëse Voni lexon një kronikë, histori dhe identifikon veten aty duke përmbushur kështu qëllimshmërinë e tekstit apo në sajë të përvojës së tij (censurës) parasheh në trajtë prolepse fatin e tij, të ardhmen. Pra nuk lexon asgjë por, nga një ngacmim - paratekst, ai projektton “të mundshmen” duke aluduar për fatin e individit duke realizuar nga ana tjetër qëllimshmërinë e personazhit.

Voni, më shumë se vizionar idealist, rindërtues i shoqërisë së vlerave dhe zbulues i qytetërimeve të hershme, zë i historisë, është në kërkim të zbulimit të vetes duke e ndërtuar në këtë mënyrë subjektin si lexim dhe përjetim të tij. Ai zotëron hapësirën më të madhe të tekstit si projektues i tij.

Projekti i Vonit është teksti sipas lexuesit që në rastin tonë ka specifikën e të qenit njëherësh dhe personazh. Ky tekst e lidh ekzistencën e

tij me interpretuesin prandaj ne flasim për iluzionin e tekstit jo për tekstin në vetvete. Në këtë iluzion lexuesi real ashtu si dhe personazhi gjendet po aq i mashtruar nga një ligjërim “që shfaqet njëherësh si ëndërr dhe si kërcënim.”² “Karpa” ushqen aventurën, ëndrrën përtej çdo parashikimi duke aluduar për fundin e lumtur, dashurinë, lirinë në cakun e përjetësisë.

“... mbasi do të vishim në këtë botë, nuk ka qënë me randësi se ku lindëm e jetuem herë këtu, herë atje, në dhé të butë ose në shkamb e në ajrin e naltësive. Tash po mbërrijmë në cak. Jemi në dhomën e smeraldit. Nëse na lyp dikush jemi atje. Barnatari. (f. 270)

Lexuesi real kërcënohet me destinimin e tij për t’u përballur me të vërtetën. Një e vërtetë që në fund të romanit, e risjell në cakun e nisjes së aventurës së tij të leximit. E vërteta njëkuptimëshe e tekstit transformohet në të vërtetën shumëkuptimëshe të interpretuesve të tij. Dhe ne bëhemi “të gjithë jemi skllavë të simboleve.” (f. 281)

Zhbërja e këtyre simboleve është mënyra e vetme për të shkuar drejt interpretimit. Teksti shndërrohet në strategjinë e autorit dhe interpretuesit për t’u shfaqur përmes tyre por edhe për t’i lexuar ata. Lëvizja rrethore që karakterizon poetikën e Camajt duket se na solli dhe ne nëpër hallka të ndryshme për të shkuar po tek origjina e problemit: leximi dhe lexuesi si strategji tekstore duke e konsideruar veprën si një test laboratorik leximi.

Leximi i romanit “Karpa” nuk është një lexim linear por vertikal, i mbivendosur si rezultat i simbolikës së ngjarjeve, dukurive dhe prirjes kah bota e brendshme e personazhit. Ashtu siç bien dakord disa studiues, dhe kjo vërtetohet dhe nga vetë teksti, përmasa vertikale në aspektin kohor shkon drejt kohës historike të përcaktuar si sistemi totalitar në Shqipëri, dhe po ashtu përbën një bosht të rëndësishëm interpretimi. Refleksionet mbi tema të ndryshme që burojnë nga problematika e kësaj periudhe si izolimi dhe mungesa e lirisë, censura, shtypja, imponimi mbarten në një të ardhme të largët si “refuzim i bashkëkohësisë”³, rebelim ndaj saj apo thyerje e cageve.

Por, pavarësisht ikjes, është pikërisht personazhi që i mbart ngjarjet si kujtesë historike, përmes një procesi të përsëritur vetëpasqyrimi duke tejkaluar kohën dhe hapësirën e veprimit për të ndërtuar në formë proleptike një histori e cila gjithsesi është produkt i së kaluarës ashtu si edhe vetë ai, të shndërruar tashmë në hije dhe vetje pa emër.

² R. Barte, *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 70 -71.

³ Sh. Sinani, *Camaj i paskajuar*, QSA, Tiranë 2011, f. 55.

Koha e shkrimit të “Karpës” përkon afërsisht me kohën e shkrimit të historisë së përpunuar nga Gjyshti që është teksti origjinar mbi të cilin ngrihet subjekti i veprës. Objektiviteti për kohën dhe ngjarjet të cilave iu referohet, kërkohet të përligjet përmes një dokumenti historik, përpunimi i të cilit nuk e mohon ndërhyrjen e subjektivitetit të shkruarit të saj.

“U muer vesh, autori me atë që shkruante në copa letrash kishte ndërmend të përpilonte një vepër mbi Karpën, po nuk delte e qartë nëse ai kish qitë cekën të shkruante kronikën apo diçka letrare.” (f. 32)

Zëvendësimi i veprimit aktiv me përfytyrime, haluçinacione, shprehje të vullnetshme e të pavullnetshme të imagjinatës së personazhit në pjesën më të madhe të subjektit, sjell dominimin e veprimit të brendshëm me efekt ngadalësues në raport me rrjedhën lineare të subjektit. Ai lind nga përplasja mes reales dhe ideale duke prodhuar një krisje që çlirohet në formën e një produkti imagjinar i cili krijon dy botë: të mundshmen dhe të dëshirueshmen.

Së fundmi, kemi një subjekt – projekt të shtrirë në kohë drejt së ardhmes dhe me simbolikë nga e kaluara, i cili vjen si projektion i vetë personazhit.

Kurba e subjektit ndërtohet si mbivendosje ngjarjesh me funksion kryesor zbulimin e personazhit sipas asaj që quhet poetika e palimpsestit. Mbivendosja e dy rrafsheve të ngjarjeve është edhe simbolike në raport me kohën reale, historike të nënkuptuar në vepër. Kohë e cila shprehet në mënyrë eksplicite në fund të romanit ku thuhet se kemi të bëjmë me përpunimin e një historie të shkruar “mbas gjase mes 1975 – 1980.” Asosacionin me këtë periudhë historike e bëjmë edhe përmes shenjave të tjera gjuhësore. Marrëdhënia e personazhit me kohën në romanin “Karpa” është një marrëdhënie komplekse sepse ai hyn në lidhje me disa kohë. Koha e përjetuar e ngjarjeve është më e gjatë se koha e jetuar.

Studimi i figurës-personazh në letërsi përbën një aspekt të rëndësishëm të studimit të veprës mbi të gjitha kur kjo është boshti i poetikës së romanit. Specifikisht personazhet e romanit “Karpa” i nënshtrohen dhe gjatë paraqitjes së tyre një lojë të dyfishtë, apo të shumëfishtë pasqyrimi. Pasqyrimi i tyre është i vullnetshëm dhe i pavullnetshëm, pasojë e rrethanave dhe dëshirë e brendshme. Ky lloj pasqyrimi dhe vetëreflektimi bën që personazhet të zbulohen në përmasën e tyre psikologjike. Kur flasim për përmasë psikologjike, sërish nuk jemi në nivel analize por thjesht zbulimi ose vetëzbulimi. Zbulimi i personazheve bëhet përmes pikëvështrimit të brendshëm dhe jo si evoluim i tyre përgjatë rrjedhës së ngjarjeve.

Situatat në të cilat ata vendosen i theksojnë më tepër cilësitë e tyre. Më tipikja ndër to është gjendja e izolimit dhe vetmisë.

Përfundimisht themi se leximi i “Karpës” është rilexim, sepse vetëm përmes tij mund të arrihet zbulimi, por dhe sepse në çdo formë ne gjendemi duke lexuar leximin e një shkrimi – Kronikën. Forma e saj më e plotë është ajo që ka kaluar përmes filtrit të lexuesit që përthyer në interpretimet e personazheve të ndryshme, të cilat bëhen mbi tekstin origjinar, të papranishëm që është Historia e Karpës.

BIBLIOGRAFI

- Barthes, R., *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë 2008.
Camaj, M., *Karpa*, Onufri, Tiranë, 2012.
Lotman, J., *Kultura dhe bumi*, SHLK & aleph, Tiranë, 2004.
Sinani, Sh. dhe Pipa A., *Parathënie*, M. Camaj Vepra, Vëllimi i tetë, Onufri, Tiranë, 2010.